



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit

<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>KOMUNA GLLOGOC</b> <b>GLLOGOC MUNICIPALITY</b>			
PRANUAR		17/12/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	030/01	59622	

**Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në  
Bashkësi nga kryesuesi i KKSB-së për gjashtëmuajorin dytë të vitit 2024**

## **HYRJE**

Ky raport paraqet aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për periudhën gjashtëmujore të dytë të vitit 2024, duke përfshirë edhe aktivitetet e gjashtëmujorit të parë. Përgatitja e këtij raporti bazohet në detyrimet ligjore të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL, ku neni 9, pika 1.8, obligon kryesuesin e KKSBB-së të informojë Kuvendin Komunal për aktivitetet e zhvilluara. Përveç KKSBB-së janë mbajtur mbledhje të **Këshillit Lokal për Sigurinë Publike** ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ gjithsej 7 takime të kryesuara nga kryesuesi i KLSP-së, 4 prej tyre në gjashtëmujorin e dytë të vitit.

### **Përmbledhja e takimeve të mbajtura**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, janë mbajtur gjithsej gjashtë (6) takime të rregullta të KKSBB-së, sipas kërkesave të nenit 11, pika 2, të Udhëzimit Administrativ. Takimet janë organizuar në përputhje me planin vjetor të punës së KKSBB-së dhe janë adresuar temat kryesore të sigurisë në Komunën e Drenasit. Tri mbledhje janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë dhe tri në gjashtëmujorin e dytë, për të cilin është përgatitë ky informim.

**Detajet e takimeve përfshinë datat e mbledhjeve, temat e diskutuara, rezultatet/veprimet, dhe Adresimi/Përgjegjësit**

<b>Datat e mbledhjes</b>	<b>Temat e diskutuara</b>	<b>Rezultatet/Veprimet</b>	<b>Adresimi/Përgjegjësit</b>
<p><b>Mbledhja e parë:</b> <b>18.01.2024</b></p> <p><b>Linku:</b><a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2024/01/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-07.12.2023.pdf">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2024/01/Ftesa-e-pare-e-KKSB-se-per-vitin-2024.pdf</a></p>	<p>1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 07.12.2023: <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2024/01/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-07.12.2023.pdf">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2024/01/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-07.12.2023.pdf</a></p> <p>2.Draft-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2024;</p> <p>3.Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së gjatë vitit 2024;</p> <p>4.Raport vjetor i punës së KKSB-së gjatë vitit 2023;</p> <p>5. Të ndryshme</p>	<p>Miratimi i Planit Vjetor dhe orarit të mbledhjeve për vitin 2024 duke përcaktuar objektivat e punës dhe qëllimet</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Mbledhje të Kuvendit/Koordinatori i KKSB-së/</p>
<p><b>Mbledhja e dytë:</b> <b>18.04.2024</b></p> <p><b>Linku:</b> <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/thirret-mbledhja-e-rregullt-e-kksb-se/">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/thirret-mbledhja-e-rregullt-e-kksb-se/</a></p>	<p>1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.01.2024: <a href="https://kk.rks-gov.net/.../procesverbali-i-mbledhjes-se.../">https://kk.rks-gov.net/.../procesverbali-i-mbledhjes-se.../</a></p> <p>2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;</p> <p>3. Diskutim për migrimin në Drenas (Kërkesë për të dhëna nga MAPL);</p> <p>4. Të ndryshme: Mobilizimi për pastrimin e mjedisit në Komunën e Drenasit.</p>	<p>Mobilizimi për fushatën ndërgjegjësuese për pastrimin e mjedisit dhe kërkesa për të dhëna për migrimin në Drenas</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/ Drejtorët</p>
<p><b>Mbledhja e tretë:</b> <b>13.06.2024</b></p> <p><b>Linku:</b> <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ftesa-per-mbledhjen-e-kksb-">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ftesa-per-mbledhjen-e-kksb-</a></p>	<p>1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.04.2024, <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/procesverbal-i-dates-18-prill-2024/">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/procesverbal-i-dates-18-prill-2024/</a>;</p>	<p>Planifikimi i aktiviteteve për fushata mjedisore dhe adresimi i sfidave sa i përket sigurisë</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/ Drejtorët</p>

<p><a href="https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-per-daten-13-06-2024/">se-per-daten-13-06-2024/</a></p>	<p>2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;</p> <p>3. Informim për fushatën “Bashkë për pastërtinë e komunës së Drenasit-zemrën e Kosovës;</p> <p>4. Te ndryshme</p>		
<p><b>Mbledhja e katërt:</b> <b>15.08.2024</b></p> <p>Linku i publikimit: <a href="https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-per-mbledhjen-e-kksb-se-per-daten-15-08-2024/">https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-per-mbledhjen-e-kksb-se-per-daten-15-08-2024/</a></p>	<p>1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 13.06.2024: <a href="https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-dhe-procesverbali-i-kksb-se-te-mbajtur-me-13-06-2024/">https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-dhe-procesverbali-i-kksb-se-te-mbajtur-me-13-06-2024/</a></p> <p>2.Gjendja me zjarre në Komunën e Drenasit, raport nga Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit- NJPZSH;</p> <p>3.Përgatitjet nga DKA për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor;</p> <p>4.Të ndryshme</p>	<p>Mobilizimi për parandalimin e zjarreve dhe vetëdijesimi i qytetarëve për kujdes në natyrë; Fillimi i vitit shkollor</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSBB-së/ Drejtorët</p>
<p><b>Mbledhja e pestë:</b> <b>24.10.2024</b></p> <p>Linku: <a href="https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/08/Ftesa-per-KKSBB-15-Gusht.pdf">https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/08/Ftesa-per-KKSBB-15-Gusht.pdf</a></p>	<p>1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 15.08.2024: <a href="https://kk.rks-gov.net/gllogoc/procesverbali-mbledhjes-se-keshillit-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-i-dates-15-08-2024/">https://kk.rks-gov.net/gllogoc/procesverbali-mbledhjes-se-keshillit-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-i-dates-15-08-2024/</a>;</p> <p>2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas</p> <p>3. Dukuria e vetëlëndimit të fëmijëve nga loja e “Tik Tok-ut”, masat nga organet përgjegjëse</p> <p>4. Raport për trajtimin e qenve endacak në Komunën e Drenasit;</p> <p>5. Të ndryshme</p>	<p>Masat parandaluese për çështjet e ngritura dhe rekomandime për drejtoritë përkatëse</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSBB-së/ Drejtorët</p>

<p><b>Mbledhja e gjashtë:</b> <b>12.12.2024</b></p> <p>Linku: <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/12/KKSB-ftesa-12-Dhjetor.pdf">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/12/KKSB-ftesa-12-Dhjetor.pdf</a></p>	<p>1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 24.10.2024, <a href="https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/11/Procesverbali-i-KKSB-te-dates-24.10.2024.pdf">https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/11/Procesverbali-i-KKSB-te-dates-24.10.2024.pdf</a>.</p> <p>2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit.</p> <p>3.Raport rreth përmbylljes së fushatës për “Parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore nga NJKDNJ dhe BGJ”.</p> <p>4.Hartimi i Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2025.</p> <p>5. Orari i mbledhjeve të KKSB-së për vitin 2025</p> <p>6.Të ndryshme</p>	<p>Hartimi i planit vjetor për punës së KKSB-së për vitin 2025 dhe miratimi i tij.</p> <p>Planifikimi dhe hartimi i orarit të mbledhjeve; Efektet e fushatës për Parandalimin e fushatës me qenie njerëzore</p>	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Mbledhje të Kuvendit/Koordinatori i KKSB-së/</p>
---	--	---	---

## Rezultatet Kryesore dhe Arritjet

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional: Në mbledhjet e KKSBB-së kanë marrë pjesë anëtarët e KKSBB-së, përfaqësues të institucioneve, monitorues, duke përfshirë KFOR-in.
- Përfshirja e komunitetit: Përmes fushatave ndërgjegjëse si “Bashkë për pastërtinë e Drenasit,” është arritur një mobilizim i gjerë për mjedisin.
- Monitorimi i sigurisë: Raportet mbi sigurinë Stacioni Policor në Komunën e Drenasit.
- Iniciativa për përmirësimet infrastrukturore për sigurinë: Është trajtuar çështja e krijimit të një nënstacioni policor në Komoran, e cila është realizuar, përkatësisht objekti i është dhënë në shfrytëzim dhe është marrë ligjshmëria e vendimit nga MAPL.

## Konkluzion dhe Rekomandime

Në përfundim, KKSBB-ja ka përmbushur me sukses objektivat e saj për periudhën Janar-Dhjetor 2024, duke adresuar çështjet kryesore të sigurisë dhe duke promovuar angazhimin e komunitetit.

## Planet për Vitin 2025

Përmirësimi i sigurisë publike dhe ndërtimi i një komuniteti më të sigurtë

Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, qytetarëve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.



Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci